



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Zhvillim i Aftësive të Dëgjimit

Ngarkesa: 4 kredite; 60 orë mësimore; 0 leksione / 60 seminare

Viti / Semestri : Viti I ,semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të jetë i aftë të dëgjojë, të kuptojë e të përvetësojë tekste të nivelit A2-B1 sipas Kuadrit Evropian të Referimit të Gjuhëve, të ligjëruara në gjuhë italiane.

Objektivat specifike lëndore:

Për nivelin A2 të gjuhës:

- 1.Të kuptojë aq sa duhet për të përmbushur nevojat e llojit konkret, mjafton që të flitet ngadalë e qartë
- 2.Të kuptojë elementët kryesorë të një bashkëbisedimi të qartë në gjuhën italiane standard për çështje që i nevojiten, si p.sh. informacione vërtetë themelore rreth personit dhe familjes, berjeve, gjeografisë lokale dhe punës etj.
- 3.Të kuptojë thelbin e transmetimeve radiofonike dhe televizive për argumenta të aktualitetit ose për tema në interesin e tij

Për nivelin B1 të gjuhës:

- 1.Të kuptojë informacione të qarta rreth çështjeve të zakonshme të lidhura me jetën e përditshme, duke kuptuar jo vetëm kuptimin e përgjithshëm por edhe atë të veçantë, mjafton që ligjëratat të shprehet qartësisht në një kontekst kryesisht familjar.
- 2.Të kuptojë çështjet kryesore të një ligjërate të qartë në gjuhën standarte e që trajton çështje familjare të përqasura kryesisht në vendin e punës, në shkollë, në kohën e lirë etj., përfshirë edhe tregime të shkurtra.
- 3.Të ndjekë e të kuptojë pikat kyçe të një diskutimi të gjatë që zhvillohet në prani të tij, mjaft të ligjërohet në gjuhën standarte dhe me një theks të qartë.

Rezultatet e të pritshme :

Kursi synon të rrisë aftësimin dëgjimor të studentit të gjuhës italiane. Kjo lëndë i ofron studentit rritjen dhe perfeksionimin e aftësisë receptive. Kursi, i konceptuar si një laborator dëgjimi për zhvillimin e aftësive të dëgjimit, duhet të realizojë saktësimin e aftësisë dëgjimore të studentit në aspektin fonetik, gramatikor, leksikor dhe kulturor. Që të arrihet rritja e aftësive receptive leksikore, gjuhësore-gramatikore kursi bazohet kryesisht në ushtrime dëgjimore individuale dhe në grup